



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.37.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS ADMINISTRATIVE TË**  
**MITROVICËS VERIORE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31**  
**DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Faruk Rrahmani, i mbështetur nga udhëheqësi i ekipit Svetlana Perovic, dhe anëtarëve të ekipit Stana Dancetovic dhe Agim Sogojeva.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	27
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	30

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore për vitin 2013 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë, Zyrtaren Kryesore Ekzekutive për ndihmën e saj gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 07.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memorandumin e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

## Opinioni

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

### *Theksimi i çështjes*

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut nuk ka shpalosur vlerën e plotë mbi pasuritë jofinanciare në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Pasuria me të cilën disponon Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut nuk ishte prezantuar plotësisht. Automjetet e dhëna donacion nga Zyra Civile Ndërkombëtare në vlerë prej 96,989€ dhe tri automjete të dhuruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël e as nuk ishin prezantuar në Pasqyra Vjetore Financiare.

**(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se, menaxhmenti kishte të dizajnuar një sistem të kontrollit të brendshëm, megjithatë kontrollet kishin funksionuar dobët gjatë vitit 2013. Në veçanti ne identifikuam:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare i kanë adresuar shumicën e kërkesave, është një numër i lëshimeve dhe pasaktësive të prezantuara për auditim. Mangësitë më të theksuara janë vërejtur te informatat e prezantuara në lidhje me pasuritë;
- Një pjesë e rekomandimeve kyçe të vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende. Kjo rezulton në kontrolle të dobëta/vlerë të dobët për para;
- Ne kemi vërejtur se menaxhimi i të hyrave nuk është në nivel të kënaqshëm. Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore nuk ka planifikuar në mënyrë reale të hyrat, ndërsa në anën tjetër ka performuar një shkallë të ulët të inkasimit;
- Dobësitë sistematike në fushën e prokurimit, që nga hartimi i planit të prokurimit, ndjekja e procedurave të prokurimit e deri te menaxhimi kontratave. Procesi i

menaxhimit të kontratave është përcjell me kontrolle joadekuate, raporte pa specifikacione të qarta si dhe mungesë të pranimit teknikë të punëve të kryera; dhe

- Procesi i dhënies së subvencioneve kishte ndodhur në mungesë të rregullores për dhënien e subvencioneve. Subvencionet e ndara nuk ishin përcjellë me raporte prapavajtëse dhe nuk ofron sigurinë se janë arritur objektivat e synuara.

**Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë se, Kryetari / Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të:**

- Sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi përfundimtar i draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitin paraprak.
- Sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Siguroj se departamenti i Prokurimit ka hartuar planin e prokurimit dhe ka evituar mangësitë nga fusha e prokurimit, duke siguruar që me prokurimet e zhvilluara janë përmbushur objektivat dhe është arritur vlera për paranë e shpenzuar;
- T'u kushtojë vëmendje të veçantë çështjeve të inkasimit të të hyrave vetanake, ndarjes së subvencioneve dhe evidentimit të pasurive në pronësi të Zyrës me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të këtyre fushave, në të cilat ishin vërejtur mangësi; dhe
- Siguroj se gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport, menaxhmenti do t'i merr në konsiderim, t'i diskutoj dhe t'i adresoj në të gjitha nivelet e menaxhimit me qëllim të forcimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Përgjigja e menaxhmenti - Auditimi 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV), të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) në PVF.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.



## 2.1 Opinioni i Auditimit

### Opinion i Pamodifikuar<sup>1</sup> me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### *Theksimi i çështjes*

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut nuk ka shpalosur vlerën e plotë mbi pasuritë jofinanciare në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Pasuria me të cilën disponon Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut nuk ishte prezantuar plotësisht. Automjetet e dhëna donacion nga Zyra Civile Ndërkombëtare në vlerë prej 96,989€ dhe tri automjete të dhuruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël e as nuk ishin prezantuar në PVF.

**(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon e planifikimit të auditimit të datës 07.10.2013, ne kemi identifikuar një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1 - Mungesa e regjistrimit të pasurive

Pasuritë në pronësi të ZAMV-së nuk janë identifikuar dhe regjistruar në mënyrë të duhur, që rezulton se ka gabime materiale në regjistrimin e pasurive. Informatat e prezantuara në PVF në lidhje me pasuritë nuk janë të plota.

---

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.

---

## E gjetura

Ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit për të verifikuar plotësinë e të dhënave sa i përket shpenzimeve kapitale për vitin 2013 dhe vitet paraprake. Në memorandumimin e auditimit të përkohshëm ne kemi këshilluar menaxhmentin për veprimet e nevojshme me qëllim të sigurimit që vlera e pasurisë në PVF të jetë e saktë.

Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të prezantuara në PVF janë materialisht të pasakta.

**Rekomandimi 1** Prioriteti i lartë - Kryetari/ZKA duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF; dhe
- PVF janë dorëzuar në formë elektronike dhe të shtypur.

Përkundër adresimit të disa çështjeve në memorandumimin e auditimit të ndërmjetëm në lidhje me kornizën e raportimit dhe shpalosjen e pasurisë fikse ne kemi vërejtur se ato nuk janë adresuar nga ana e menaxhmentit. Ne kemi identifikuar këto mospërputhje:

## Çështja 2. Prezantimi i Pasqyrave Vjetore Financiare - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në shënimin 30 dhe 31: Përmbledhja e pasurive jo-financiare mbi dhe nën 1000€, ne kemi vërejtur se nuk ishte prezantuar e tërë pasuria me të cilën disponon ZAMV. Ne testuam automjetet e dhëna donacion nga ICO në vlerë prej 96,989€ dhe tri automjete të dhuruara nga Ministria e Pushtetit Lokal, të cilat nuk ishin të regjistruara në regjistrin kontabël.
- Po ashtu, në regjistrin e e-Pasurive figurojnë pajisje dhe pasuri të ndryshme të cilat nuk kanë kurrfarë vlere materiale.
- Rreziku** Mangësitë e evidentuara te pasuritë fikse, e shtojnë rrezikun që pasuritë të mos prezantohen gjendjen e saktë të tyre në PVF-të e vitit 2013.
- Rekomandimi 2** Kryetari/ZKA duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2014 të adresojë fushat që konsiderohen me rrezik të lartë të gabimit ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme. Duhet të sigurohen trajnime adekuate për stafin që ata të jenë të aftë për të regjistruar dhe përgatitur PVF me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullat financiare.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ZAMV-ja kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim: Ne kemi vërejtur se ishin përmbushur raportimet si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore; dhe
- Raportin mbi obligimet e papaguara.

Ndërsa nuk ishin përgatitur dhe dorëzuar raportimet si në vijim:

- Plani preliminar dhe plani final i prokurimit;
- Nuk ka kryer vetëvlerësimin dhe vlerësimin e rrezikut; dhe
- Raportet operative (të performancës).

- Rekomandimi 3** **Prioritet i lartë** - Kryetari/ZKA duhet të sigurojë se kërkesat e raportimit të jashtëm janë përmbushur plotësisht për të arritur një funksionim konform kornizës së raportimit të jashtëm.

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të përkrahin menaxhmentin në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe ngritjen e aspekteve tjera të aktiviteteve operative. Ne kemi shqyrtuar përgjigjet në rekomandimet tona nga viti 2012.

Menaxhmenti i ZAMV-së kishte përgatit me kohë planin veprues për zbatimin e rekomandimeve.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF për vitin 2012 për ZAMV-në ka rezultuar me gjashtë rekomandime kryesore.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, ne kemi vërejtur se dy rekomandime janë implementuar, dy janë adresuar pjesërisht, ndërsa dy rekomandime tjera nuk janë adresuar fare.

---

### Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse ZAMV nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet financiare kyçe, siç janë përgatitja e procesit të prokurimit, zhvillimi i proceseve të prokurimit dhe mos regjistrimi i pasurisë kanë rezultuar në:

- Jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe pranim të vlerës së vogël për para në praktikën e prokurimit; dhe
- Dobësi të njëjta dhe përsëritje të rekomandimeve.

**Rekomandimi 4** Kryetari/ZKA duhet të sigurojë që plani i veprimit të rishikohet dhe në mënyrë të qartë të përcaktohet një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me anëtarët e identifikuar të stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në ato të një rëndësie më të madhe

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Ne kemi vërejtë se ZAMV nuk e ka marrë në konsideratë vetë-vlerësimin në kuadër të MFP në lidhje me vlerësimet e PEFA-s dhe vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi të hyrat janë në nivelin e mesëm, derisa kontrollet ndaj numrit më të madh të fushës së shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm me qëllim të parandalimit të humbjeve financiare të ZAMV, vlerë të ulët për para dhe menaxhim jo efektiv të projekteve. Fushat kyçe që kërkojnë më shumë përmirësim janë: Prokurimi, Realizimi i Buxhetit dhe Auditimi i Brendshëm.

## 4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ZAMV, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>4,615,645</b>	<b>4,867,602</b>	<b>3,745,762</b>	<b>1,258,758</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	4,517,965	4,595,965	3,573,187	1,258,658
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>		21,832	20,500	
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	97,680	97,680	0	
Donacionet e jashtme	-	152,125	152,075	-

Të dhënat në Tabelën 1 tregojnë se buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 251,957€. Ky ndryshim është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 21,832€, donacioni i Qeverisë së Norvegjisë e cila ka qenë në vlerë prej 149,625€, donacioni i Qeverisë Çeke në vlerë prej 2,500€ dhe nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL) 78,000€.

Buxheti është shpenzuar rreth 77% në nivel të përgjithshëm, dhe mund të vlerësojmë një ekzekutim i kënaqshëm, duke pasur parasysh rrethanat politike në të cilat ka operuar ZAMV.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

<sup>4</sup> Të hyrat e planifikuara dhe të inkasuara në vitin vijues

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (€)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>4,615,645</b>	<b>4,867,603</b>	<b>3,745,762</b>	<b>1,258,658</b>
Pagat dhe Mëditjet	2,818,151	2,896,151	2,376,703	857,591
Mallrat dhe Shërbimet	349,090	648,715	628,519	130,752
Shërbimet komunale	43,572	43,572	39,071	642
Subvencionet dhe Transferet	47,000	71,332	49,584	0
Investimet Kapitale	1,357,832	1,207,832	651,885	269,673

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja substanciale e buxhetit për paga dhe mëditje këtë vit ka ardhur si rezultat i planifikimit të transferimit të stafit të punësuar në shëndetësi dhe arsim në sistemin e pagave të Kosovës. Një rritje shtesë e buxhetit për Paga dhe Mëditje për 78,000€ është rezultat i ndarjes nga ana e MAPL. Përkundër buxhetit në dispozicion, shuma prej 519,448€ nga kjo kategori ka mbetur e pashpenzuar si rezultat i ngecjeve të këtij procesi. Procesi i transferimit është finalizuar në tremujorin e fundit dhe si rezultat i kësaj në këtë periudhë janë shpenzuar rreth 43%;
- Rritja e buxhetit për Mallra dhe Shërbime me 299,625€ përfshin pranimet nga donatorët e jashtëm në shumë prej 149,625€, dhe pjesa tjetër e mjeteve janë transferuar nga kategoria e Investimeve Kapitale prej 150,000€. Nëse përjashtojmë pjesën e realizimit të buxhetit nga ana e donatorit, 40% të kësaj kategorie është shpenzuar për marrjen me qira të ndërtesave dhe tokën për deponi;
- ZAMV në kategorinë e Subvencioneve ka pasur rritje prej 24,332€. Kjo ka ardhur nga të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar në vlerë prej 21,832€ dhe donacionit nga Qeveria e Çekisë në vlerë prej 2,500€. ZAMV nga kjo kategori ka arritur të shpenzoj buxhetin prej 69%; dhe
- Përkundër zvogëlimit të buxheti në kategorinë e Investimeve Kapitale për 150,000€ realizimi i buxhetit nga kjo kategori ka qenë 54%. Kjo ka ardhur si rezultat i mos realizimit të projekteve kapitale.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	97,680	97,680	10,612	107

Siç tregon Tabela 3, në vitin 2013 të hyrat shënojnë rritje në krahasim me vitin 2012. Edhe pse shkalla e mbledhjes të hyrave në krahasim me planin është vetëm 10%, fakt pozitiv është se ZAMV ka filluar me zbatim të rregulloreve për mbledhjen e të hyrave, dhe kjo gjë është inkurajuese.

#### Çështja 4 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur, posaçërisht në investime kapitale dhe subvencione e transfere. Ky buxhet ka shkuar në suficit si pasojë e mos realizimit të projekteve.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit për projekte kapitale ka ndikuar që ekzekutimi i buxhetit të jetë i ulët. Kjo mund të ndikojë në mos arritjen e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 5** Kryetari/ZKA duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.



## 4.2 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Përshkrimi

Të hyrat e planifikuara për vitin 2013 kanë qenë 97,680€, ndërsa janë realizuar 10,612€. Ato kanë pasur të bëjnë me të hyrat nga taksat administrative, nga lëshimi i certifikatave të lindjes, certifikatave të vdekjes dhe lëshimi i lejeve të punës.

---

### Çështja 5 – Planifikimi i të hyrave – Prioritet i lartë

**E gjetura** ZAMV kishte paraqitur një plan mjaft ambicioz për mbledhjen e të hyrave vetanake. Mirëpo ky plan nuk ishte realizuar as përafërsisht për shkak të rrethanave të njohura politike/mundësive të kufizuara, për shtrirjen dhe zbatimin e pushtetit të plotë në këtë njësi administrative.

**Rreziku** Shuma e të hyrave të planifikuara për vitin 2013 tregon për një planifikim shumë ambicioz dhe të pa analizuar mirë. Mungesa e regjistrimit të plotë dhe të saktë e të gjithë borxhlinjve vështirëson parashikimin e drejtë të rrjedhës së inkasimit të të hyrave.

**Rekomandimi 6** Ne rekomandojmë Kryetarit/ZKA që t'i çaset një planifikimi racional për të hyra, duke miratuar mekanizma të qartë të inkasimit. Fillimisht duhet siguruar një bazë e plotë për obliguesit tatimorë dhe obliguesve në baza tjera.

### Çështja 6 – Barazimi i të hyrave – Prioritet i lartë

**E gjetura** Kemi vërejtur se departamentet që inkasojnë të hyra nuk kryejnë harmonizime periodike të të hyrave të mbledhura me departamentin e financave.

**Rreziku** Mos barazimi i të hyrave në mes të departamenteve mund të rezultojë me dallime materiale dhe paraqitje jo të drejtë të të hyrave.

**Rekomandimi 7** Kryetari/ZKA duhet të siguroj se po bëhen harmonizime të rregullta në mes të departamenteve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Këto barazime duhet të bëhen edhe me gjendjen e Thesarit dhe të gjitha diferencat duhet të sqarohen.

## 4.3 Shpenzimet

### 4.3.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Blerjet e realizuara me anë të prokurimit për vitin 2013 kanë qenë 831,155€. Ne kemi testuar 35 kontrata të cilat janë proceduar me anë të procedurave të prokurimit dhe kemi testuar të gjitha pagesat lidhur me këto kontrata.

---

#### Çështja 7 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Nga shqyrtimi i 35 kontratave ne kemi identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta. Në veçanti, çështjet e mëposhtme:

- ZAMV nuk ka përgatitur e as dorëzuar planin paraprak dhe përfundimtar të prokurimit;
- Në tre raste kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertat si të përgjegjshme, pavarësisht faktit se dosjet e tenderit që janë dorëzuar nga ana e Operatorëve Ekonomik (OE) nuk kanë qenë të nënshkruara dhe të vulosura nga ana e OE-ve;
- Proceset e prokurimit nuk janë zhvilluar në pajtim me rregullat e prokurimit publik, dhe në disa raste kontratat nuk janë realizuar në tërësi sipas specifikimeve të përcaktuara;
- Trajtimi i OE-ve në disa procese të prokurimit ka qenë i pabarabartë;
- Në tenderin "Shërbimet e dezinfektimit dhe deratizimit të bregut të lumit Ibër" është shpërblyer me kontratë OE në vlerë prej 9,690€, që e kishte licencën me afat të skaduar (jo valide); dhe
- Në tri raste kemi vërejtur se mungojnë kërkesat për inicimin e procedurave të prokurimit.

**Rreziku** Të gjeturat e cekura më lartë tregojnë se proceset e prokurimit në ZAMV nga fillimi janë përcjell me shumë mangësi. Kontrollat e menaxhimit të këtij procesi ishin në nivel të ulët dhe si rezultat i kësaj ekziston rreziku që me prokurimet e kryera organizata nuk ka arritur të pranojë vlerën më të mirë për paratë e shpenzuar.

**Rekomandimi 8** Kryetari/ZKA duhet të siguroj përgatitjen e planit preliminar dhe final të prokurimit dhe të siguroj se menaxhimi i proceseve të prokurimit bëhet në përputhje të plotë me rregullat e prokurimit. Po ashtu, vëmendje duhet t'i kushtohet trajtimit të barabartë të OE-ve dhe menaxhimit të kontratave për të siguruar kryerjen e punëve sipas specifikave të kontratave.

Kryetari/ZKA - gjithashtu duhet të vlerësoj kapacitetet profesionale të zyrtarëve të prokurimit, si dhe të bëj të mundur ndjekjen e trajnimeve shtesë në fushën e prokurimit.

### **Çështja 8- Mangësi në menaxhimin e kontratave - Prioriteti i Lartë**

Ne kemi identifikuar se disa kontrolle menaxheriale nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente gjatë zhvillimit të prokurimit dhe kanë rezultuar me dobësitë në vijim:

**E gjetura** Te projekti "Rikonstruktimi dhe ndërtimi i instalimit elektrik në ndërtesën e bibliotekës" në vlerë prej 9,728€ vërehet se nuk ka pasur mbikëqyrje efektive të këtij projekti. Raporti i Organit mbikëqyrës, nuk ndërlidhet as me datën e kontratës e as me datën e pagesës. Raporti i organit mbikëqyrës e ka datën 17.12.2012, kontrata është nënshkruar me datë 17.04.2013, kurse, pagesa ka ndodhur me datë 22.05.2013.

Te kontrata "Shërbimet e projektimit të qendrës laboratorike dhe diagnozës në Mitrovicë" është bërë pagesa e shërbimeve me datë 24.07.2013, ndërsa projekti është pranuar nga komisioni me datë 11.08.2013.

**E gjetura** Te kontrata "Ndërtimi dhe rindërtimi i shtëpive dhe ndërtesave të banimit në Mitrovicën Veriore" në pesë Lote, me vlerë prej 198,000€, kemi vërejtur se:

1. Kanë munguar kriteret sipas të cilave do të bëhej përzgjedhja e personave që do përfitojnë për ndërtimin e shtëpive, përkundër që kërkesat janë shqyrtuar nga komisioni prej pesë anëtarëve;
2. Ditari i ndërtimit është mbajtur vetëm në rastin e Lotit 1 në vlerë prej 27,490€, derisa për katër Lotet tjera nuk kanë ofruar dëshmi se ditaret e punës janë mbajtur; dhe
3. Pranimi Teknikë që vërteton se janë përmbushur shërbimet e kontraktuara mungonte në tre Lote, edhe pse ishte paguar e gjithë vlera e kontraktuar.

**Rreziku** Të gjeturat në lidhje me menaxhimin e kontratave tregojnë se ekziston rreziku që mangësitë kyçe kanë ndodhur në finalizimin e projekteve dhe menaxhimi i kontratave nuk ka arritur të parandalojë këto parregullsi. Krejt kjo ka shkaktuar që të ndodhin pagesa para përfundimit të punëve, përzgjidhje të përfituesve pa kritere, mbikëqyrje të dobët të projekteve dhe mangësi tjera.

**Rekomandimi 9** Kryetari/ZKA duhet të siguroj mbikëqyrje adekuate gjatë zbatimit të procesit të prokurimit, nga faza e inicimit të procesit deri te finalizimi i projektit. Dobësitë e vërejtura tregojnë se duhet të ndërmerren masa të duhura për përmirësimin e kontrollit në mbikëqyrjen e projekteve në kuadër të ZAMV-së.

#### **Çështja 9 - Zyra e Prokurimit zhvillon procedura të prokurimit në mënyrë jo të rregullt me rastin e Hapjes së tenderëve**

**E gjetura** Çmimi i ofruar nga njëri prej operatorëve ekonomik është lexuar gabimisht sipas deklaratës së zyrtarit të prokurimit. Nëse lexohet gabimisht një çmim në procesin e Hapjes së tenderëve atëherë nuk lejohet asnjë veprim i mëtutjeshëm. Komisioni për vlerësim e konstaton gjendjen dhe nënshkruan raportin për anulim dhe ri-tenderim. Procesverbali i hapjes së ofertave është nënshkruar nga zyrtarja e prokurimit por jo nga shefi i prokurimit. Procesverbali i hapjes është korrigjuar nga shefi i prokurimit dhe nuk është nënshkruar nga ai (shefi) dhe as nga anëtarët e komisionit.

**Rreziku** Zhvillimi i procedurave të prokurimit ( procedura e hapjes së tenderit ) jo në harmoni me LPP krijon parakushte për trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi 10** Kryetari/ZKA të sigurohet se zyrtarët e prokurimit veprojnë konform ligjit në fuqi për prokurim publik edhe me rastin e hapjes së tenderëve, siç parashihet edhe me nenin 58 të L PP.

## Çështja 10 - Shfrytëzim i shpeshtë i çmimeve me Kuotim - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Nga 62 kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2013, ne kemi vërejtur se 51 kontrata kanë qenë me vlerë minimale ose me vlerë të vogël. Vlera e tyre e përgjithshme ka qenë 246,105€. Kemi analizuar kontratat me qëllim të vlerësimit se a ka pasur ndarje të tenderëve për blerjen e artikujve të njëjtë.

Testet tona kanë treguar, në periudha të ndryshme të vitit 2013 janë nënshkruar gjashtë kontrata për blerjen e inventarit mjekësorë, pajisjeve dhe materialit në vlerë prej 47,488€ dhe tre kontrata për blerjen e pajisjeve për shkolla në vlerë prej 25,790€. Arsyet për shfrytëzim të shpeshtë të këtyre procedurave që kanë rezultuar me kontrata në vlera të vogla dhe minimale kanë qenë si në vijim:

- Vlerësimi jo i mirë nevojave; dhe
- Pamundësia e mbledhjes së kërkesave nga ana e drejtorëve të departamenteve për blerjen e artikujve gjatë vitit.

**Rreziku** Ndarja e tenderëve dhe anashkalimi i procedurave të hapura shton rrezikun që ZAM nuk do të mund të pranojë vlerën për paranë e shpenzuar. Prokurimi me procedura të tilla mund të rezultojë me blerjen e artikujve të njëjtë, por me çmime të ndryshme.

**Rekomandimi 11** Kryetari/ZKA duhet të sigurojë planifikim më të mirë në mënyrë që produktet e ngjashme të grupohen me qëllim të tenderimit të përbashkët me qëllim të blerjes të produkteve me çmime sa më të mira.

### 4.3.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Rritja substanciale e shpenzimeve për paga dhe mëditje posaçërisht në tremujorin e fundit ka ardhur si rezultat i transferimit të stafit të punësuar në shëndetësi dhe arsim në sistemin e pagave të Kosovës. Një rritje shtesë prej 78,000€ për këtë qëllim e ka ndarë edhe MAPL.

Përkundër buxhetit në dispozicion shuma prej 519,448€ nga kjo kategori ka mbetur e pashpenzuar si rezultat i ngecjeve të këtij procesi. Procesi i transferimit është finalizuar në tremujorin e fundit dhe si rezultat i kësaj në këtë periudhë janë shpenzuar rreth 43% e buxhetit. Buxheti i planifikuar për paga dhe mëditje për vitin 2013 ka qenë 2,896,151€, ndërsa është shpenzuar 2,376,703€, në një përqindje prej 82%.

### **Çështja 11 - Kontratat e Punës - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Të punësuarit në shëndetësinë sekondare nuk kanë qenë të regjistruar në sistemin e pagave të Kosovës deri në vitin 2013. Ndërsa në mbledhjen e mbajtur me datë 18.01.2013, ZAMV sjell vendimin me të cilin punëtorët për të përmbushur të drejtën për pranimin e pagave dhe për të nënshkruar kontratën e punës me ZAMV duhet të dorëzojnë dokumentacionin relevant - Letërnjoftimin e Kosovës, Kontratën aktuale të punës, Librezën e Punës dhe xhirollogarinë e bankës.

Ne testuam 16 mostra për të vërtetuar nëse ishin plotësuar kriteret e vendosura për tu bërë transferi. Ne vërejtëm se tre zyrtar janë futur në sistemin e pagave edhe pse nuk kanë përmbushur kërkesat e kërkuara, pra nuk kanë dorëzuar dokumentacionin relevant.

**Rreziku** Mungesa e dokumentacionit të kërkuar gjatë transferimit të stafit mund të rezultojë me dëmtim të procesit dhe shkelje të kriterëve të vendosura nga vetë ZAMV.

**Rekomandimi 12** Kryetari/ZKA duhet të sigurojë se pozitat që i përkasin tre punëtorëve të identifikuar, të cilat janë jashtë kriterëve të vendosura, duhet të adresohen si çështje urgjente.

### **Çështja 12 -Pozita në listat e pagave nuk është në harmoni me kontratat - Prioriteti Mesatar**

**E gjetura** Testimet tona kanë zbuluar jo harmonizim me Ligjin mbi shërbimin civil (o3/L-149). Sipas Ligjit, titulli i pozitës së punës në sistemin e pagave duhet të jetë në pajtim me titullin e pozitës së punës në akt-emërim. Ne kemi identifikuar 18 raste kur të punësuarit në departamentin e Arsimit kanë pasur tituj të pozitës në listat e pagave që kanë qenë të ndryshme në krahasim me kontratat e punës.

**Rreziku** Mos harmonizimi i titujve të pozitës me listat e pagave me ato në Kontratat e punës humb besueshmërinë e pozitave të miratuara, dhe rezulton me pagesa të pa harmonizuara në raport me kontratat e punës.

**Rekomandimi 13** Kryetari/ZKA të vazhdoj bashkëpunimi me MAP-in për harmonizimin e informacionit sa i përket titujve të pozitave të punës, në mënyrë që të punësuarit të paguhen në mënyrë adekuate për pozitat e tyre të punës.

### 4.3.3 Subvencionet dhe Transferet

#### Përshkrimi

Sipas rishikimit analitik, buxheti i miratuar për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve për vitin 2013 ka qenë 71,332€, nga të cilat janë shpenzuar 49,584€ ose 69,5%. Ne kemi testuar tre mostra në vlerë prej 20,000€ me qëllim të verifikimit të procesit të ndarjes së subvencioneve dhe raportimit mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara.

---

#### Çështja 13 – Mungesa e Rregullores - Prioritet i lartë

**E gjetura** Subvencionet e ZAMV u janë dhënë entiteteve publike, entiteteve publike kulturore, entiteteve jo-publike dhe përfituesve individual. ZAMV ende nuk ka miratuar Rregulloren e cila përcakton kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve

**Rreziku** Mungesa e Rregullores së brendshme për subvencione paraqet rrezik që subvencionet të ndahen pa kriteret dhe sipas interesave të ndryshme. Ndarja pa kriteret shkakton shpenzimin e parasë duke rrezikuar në mos arritjen e qëllimit të subvencionit.

**Rekomandimi 14** Kryetari/ZKA duhet të siguroj hartimin e Rregullores e cila në mënyrë të qartë përcakton kriteret, procedurat dhe raportimin e shpenzimeve të subvencioneve.

#### **Çështja 14 - Ndarja e subvencioneve - Prioritet i lartë**

**E gjetura** ZAMV ka ndarë pako me ushqime për qytetarë në nevojë. Vlera e kontratës që ka nënshkruar ZAMV për furnizim me pako është 16,000€. Ne kemi vërejtur se përzgjedhja e EO është bërë pa procedura të prokurimit dhe se është përzgjedhur kompania e cila kryen punë të ndërtimtarisë. Gjithashtu, përfituesit e subvencioneve janë përzgjedhur pa kritere dhe në mungesë të komisionit për ndarje.

**Rreziku** Lidhja e kontratave me anashkalim të procedurave të prokurimit është në kundërshtim me rregullat e prokurimit dhe shton rrezikun që të nënshkruhen kontrata të dëmshme për organizatën buxhetore. Nënshkrimi i kontratës së tillë duhet t'i nënshtrohet një procedure të hapur të prokurimit, me qëllim të arritjes së vlerës më të mirë për parandë.

**Rekomandimi 15** Kryetari/ZKA duhet të siguroj që në të gjitha rastet kur kërkohet që Organizata buxhetore të kryej prokurimin dhe kur është e mundur, të zbatohen rregullat e prokurimit. Gjithashtu, gjatë ndarjes së subvencioneve të zbatohen kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të subvencioneve.

**E gjetura** Te Lëndët "Pushimi në bregdet të nxënësve të shkollës Speciale të Mitrovicës" në shumë prej 3,500€, dhe „Community Building Mitrovica CBM“ në vlerë prej 500€ mungojnë dëshmitë për arsyen e dhënies së subvencionit, dhe raportet që vërtetojnë qëllimin e shpenzimeve.

**Rreziku** Ndarja e subvencioneve në mungesë të dokumentacionit komplet si dhe mungesa e informacionit prapavajtës për shpenzimet, shton rrezikun që mjetet e ndara për subvencione mos të shfrytëzohen sipas kërkesave dhe mjetet publike të shpenzohen në mënyrë joefikase.

**Rekomandimi 16** Kryetari/ZKA duhet të siguroj që shfrytëzuesit të dorëzojnë raporte mbi shpenzimin e mjeteve të ndara, si dhe çdo shfrytëzues të jetë komplet sa i përket dokumentacionit. Po ashtu, duhet t'i shqyrtojë rastet e identifikuar për të përcaktuar se pse kriteret nuk janë aplikuar dhe të zhvillojë kontrole të zgjeruara për të shmangur përsëritjen e rasteve të tilla



## 4.4 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

ZAMV ka shpalosur vlerën e përgjithshme të pasurisë në shumë prej 673,458€. Kjo shumë nuk paraqet pasurinë e përgjithshme me të cilën disponon ZAMV. Përveç kërkesës që pasuria të shpaloset në mënyrë të plotë, është i nevojshëm edhe regjistri i plotë i pasurisë së përgjithshme jo financiare.

---

#### Çështja 15 - Mos regjistrimi i pasurisë - Prioritet i lartë

**E gjetura** ZAMV nuk ka arritur të vë në funksion të plotë softuerin e-Pasuria. ZAMV nuk posedon një listë të plotë dhe complete të pasurisë. Zyrtari për pasuri ende nuk ka arritur të regjistroj pasurinë e plotë me të cilën disponon komuna, e në disa raste pasuria është regjistruar pa vlerë financiare. Si rezultat i procedimit jo të plotë të informacioneve në softuer, raportet që gjenerohen nuk ofrojnë vlerën e saktë të pasurisë.

Ne kemi vërejtur se nuk ishte prezantuar e tërë pasuria me të cilën disponon ZAMV. Ne testuam automjetet e dhëna donacion nga ICO në vlerë prej 96,989€ dhe tri automjete të dhuruara nga MAPL të cilat nuk ishin të regjistruar në regjistrin kontabël të ZAMV.

Komisioni për inventarizim nuk e ka bërë inventarizimin vjetor dhe vlerësimin e pasurisë në pronësi të ZAMV. Po ashtu në regjistrin e e-Pasurisë figurojnë disa pajisje të cilat nuk kanë kurrfar vlere.

**Rreziku** Mungesa e regjistrave të plotë dhe të saktë të pasurisë financiare dhe jo-financiare shton rrezikun e keqpërdorimit, humbjes ose përvetësimit të pasurisë sepse ekzistenca e pasurisë nuk mund të përcaktohet.

**Rekomandimi 17** Ne rekomandojmë Kryetarin/ZKA që të siguroj që e tërë pasuria me të cilën disponon ZAMV të regjistrohet në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu, në fund të çdo viti duhet të themelohet komisioni për inventarizimin e pasurisë dhe gjendja e inventarizimit të harmonizohet me regjistrin e pasurisë.

## 4.4.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Raporti i obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 godine ka qenë 1,549€. Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin 2014. Faturat nuk janë paguar sepse janë pranuar me vonesë.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka planin strategjik dhe vjetor. NJAB përbëhet nga një auditor i cili njëkohësisht është edhe drejtor. Për vitin 2013 NJAB ka planifikuar katër auditime, ndërsa ka përfunduar tri.

---

### Çështja 16 - Auditimi i brendshëm - Prioritet i lartë

**E gjetura** Ne kemi vërejtur se ndaj fushave kyçe siç janë prokurimi dhe menaxhimi i pasurisë nuk janë kryer auditime. Në këto fusha janë identifikuar të gjeturat më të ndjeshme nga auditimet e ZAP-it. Po ashtu, nuk është themeluar Komiteti i Auditimit (KA).

**Rreziku** Mos zhvillimi i auditimeve në fushat kyçe zvogëlon sigurinë e menaxhmentit nëse sistemi i kontrollit të brendshëm është plotësisht në veprim dhe kontrollet e aplikuara janë adekuate me kërkesat. Mungesa e KA zvogëlon nivelin e sfidës dhe mbështetjes për NJAB duke përfshirë mbështetjen në implementimin e rekomandimeve të tyre.

**Rekomandimi 18** Kryetari/ZKA duhet të sigurojë themelimin e një Komiteti të Auditimit dhe se aktiviteti i ardhshëm i NJAB të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik. Kjo do t'i ofronte menaxhmentit sigurinë e arsyeshme se kontrollet janë të dizajnuara mirë dhe operojnë si duhet.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Raportimi i jashtëm	Rekomandojmë ZKE që për vitin 2013 të siguroj përmbushjen e të gjitha kërkesave për raportim të jashtëm.	Po		
2. Prokurimi	ZKE duhet të zbatoj praktikën e nënshkrimit të kontratave vetëm pasi që respektohen procedurat e prokurimit.	Pjesërisht		Në disa prokurime nuk janë respektuar procedurat.
3. Prokurimi	ZKE duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për rritjen e kontrollit të prokurimit, nëse zyrtarët e prokurimit nuk kanë shkathësi të duhur atyre duhet mundësuar aftësim profesional.	Po		
4. Prokurimi	ZKE duhet të siguroj që procesi i prokurimit zhvillohet në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik. Specifikacioni i saktë i çmimeve në ofertë është një nga kërkesat kryesore të vlerësimit.	Jo		Nuk janë marrë masa
5. Prokurimi	Mos respektimi i procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzimeve përcjellëse ka sjell deri te pagesat e parregullta dhe humbjeve financiare për ZAMV. Ekziston rreziku se nuk është pranuar vlera për paranë e shpenzuar.	Jo		Nuk janë marrë masa
6. Resurset Humane	ZKE duhet të ndërmerr shqyrtimin sistematik të dosjeve të punëtorëve	Pjesërisht		Të gjitha dosjet nuk janë të rregulluara.